



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 349/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), dega në Mitrovicë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

**V E N D I M**

**HUDHET** si e palejuar ankesa e parashtruar nga subjekti politik KDTP dega në Mitrovicë.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11.06.2014, nga subjekti politik KDTP, dega në Mitrovicë, në të cilën pretendohet se sipas raportit në KKZ në Qendrën e votimit 1102x/16D KDTP ka 12 vota, ndërsa në vebfaqen e KQZ-së janë evidentuar 2 vota. Pra sipas parashtruesit të ankesës në raportin e KQZ-së mungojnë 10 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultati preliminar i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas Nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj”. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga një anëtar i KDTP- së që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të Nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hedh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 349/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit**

**Muhamet Rexha**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.